



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 56, Datë 26.03.2020

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S, NR. 228, DATË 26.10.2018, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “OSOJA HPP” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “OSOJE” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1952 KW NË ZONËN E MOGLICËS –KORÇË (LUMI OSOJË)

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s, Nr. 228, Datë 26.10.2018, për licencimin e shoqërisë “OSOJA HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “OSOJE” me kapacitet të instaluar 1952 kW në zonën e Moglicës–Korçë (Lumi Osojë)”

Konstatoi se:

Me Vendimin nr. 228, datë 26.10.2018, Bordi i ERE-s ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “OSOJA HPP” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osoja” me fuqi 1952 kw, dhe vendndodhje në zonën e Moglicës-Korçë (Lumi Osojë) për një afat 30(tridhjetë) vjeçar.

2. Shoqëria “OSOJA HPP” sh.p.k, duhet të përcjellë në ERE, ndryshimin e kontratës me Nr. 1755 Rep, Nr. 776/3 Kol, datë 25.07.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Osojë”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 529, datë 26.02.2020, për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e plotësisimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.
- Shoqëria me shkresën nr. 10 prot., datë 04.03.2020, protokolluar në ERE me nr. 529/1 prot., datë 06.03.2020, ka depozituar në ERE dokumentacionin si vijon:
 - Kopje kontrate me nr. 2255 rep, nr. 1106/2 kol datë, 26.10.2018 të lidhur me palët: MIE dhe shoqëria “OSOJA HPP” shpk: Për Amendim Kontratën për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Hidrocentralit Osojë me kapacitet prodhues 1.952 kW në lumin e

Osojës degë e lumit Devoll, në Bashkinë Korçë, Qarku Korçë, me nr. 1755 Rep; nr. 776/3 Kol, datë 25.07.2017, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive: “Favina” sh.p.k; “Favina 1” sh.p.k dhe “ Osoja Energy” sh.p.k, me përfaqësues shoqëria “Favina”, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “OSOJE” me kapacitet prodhues 1952 kw, në lumin e Osojës, degë e lumit Devoll, në bashkinë Korçë, Qarku Korçë.

- Në nenin 2 të kontratës sipërcituar është parashikuar se: *Kudo në kontratë togfjalëshi: "Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "Favina" sh.p.k., "Osoja Energy" sh.p.k. dhe "Fava 1" sh.p.k.", zëvendësohet me togfjalëshin: Shoqëria "Osoja HPP" sh.p.k.*
- *Shoqëria “OSOJA HPP” sh.p.k rezulton të ketë plotësuar detyrimin e parashikuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE nr. 228, datë 26.10.2018.*

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Në vendimin e bordit të ERE nr. 228, datë 26.10.2018 “Mbi licencimin e shoqërisë "Osoja HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Osoja” me fuqi 1952 kW, dhe vendndodhje në zonën e Moglicës-Korçë, (Lumi Osojë), bëhet ndryshimi si më poshtë:
 - a. Pika 2 shfuqizohet
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë palët e interesit lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI